



KOKSH

INFORMACIONE

MARS - PRILL 2008

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
KOKSH & KOK..... FQ2

ASAMBLEJA E SHOQATËS SË
KOMITETEVE OLIMPIKE
KOMBËTARE..... FQ3

SEMINAR - WORKSHOP
ME SEKRETARËT
E FEDERATAVE FQ3

MBLEDHJET E KOMISIONEVE
TË KOKSH..... FQ 4-5

MBLEDHJE KOMISIONI
TEKNIK COE..... FQ6

MBLEDHJE KOMISIONI
TEKNIK ICMG..... FQ6

AKTIVITETE &
TAKIME FQ 6 -7

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar
Rruga: "Muhamet Gjollësia", ish-21 Dhjetori, Tiranë
Tel: +355 4 2235 249; Fax: +355 4 2240 565
e-mail: secretariat@nocalbania.org.al

Konferenca e IV Ndërkombëtare e CIO-s “Femra dhe Sporti”

Konferenca e IV Ndërkombëtare e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar “Femra dhe Sporti” u zhvillua këtë herë në Jordani, pikërisht pranë ujërave të Detit të Vdekur, në një nga Qendrat Konferenciale Mbretërore më të mëdha të Jordanisë, nga data 8 Mars deri në datën 10 Mars 2008, ku nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, z. Jacques Rogge dhe shumë përfaqësues të rëndësishëm të CIO. Me moton "Sporti si mjet i ndryshimit social", kjo Konferencë u organizua nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Jordanez. Pjesëmarrëse ishin mbi 200 gra e vajza nga e gjithë bota, të cilat mbrëmjen e dt. 8 Mars u



President i CIO, Jacques Rogge; zv/Presidente e KOKSH, Ela Tase; PR & Media Relations KOKSH, Dena Grillo.

mblodhën së bashku në një mbrëmje Gala organizuar nga Mbreti Abdullah II, i cili përshëndeti këtë Konferencë. Nga Shqipëria morën pjesë zj. Ela Tase, zv/Presidente e KOKSH dhe njëkohësisht Kryetare e Komisionit “Femra dhe Sporti” dhe Përgjegjësjë e Marrëdhënieve me Median pranë KOKSH, zj. Dena Grillo.

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Komiteti Olimpik i Kosovës, përfaqësuar nga presidentët respektivë, z. Hysen Domi dhe z. Besim Hasani, firmosën më datë 28 Mars 2008 Protokoll – Marrëveshjen e Bashkëpunimit, me qëllim shkëmbimet e eksperiencave Sportive dhe Olimpike, në kuadrin e vendosjes së marrëdhënieve të përbashkëta të vëllazërisë dhe të miqësisë, si një faktor tepër i rëndësishëm që do të kontribuojë jo vetëm në ruajtjen e paqes në rajon por edhe jashtë tij, konform rregullave të Kartës Olimpike. Përveç kësaj, objektiva të tjera kryesore të kësaj marrëveshjeje ishin edhe:

- Bashkëpunimi intensiv i Federatave Sportive përkatëse
 - Koordinimi i veprimtarive lobuese të përbashkëta me Federatat Ndërkombëtare për njohjen sa më të shpejtë të Federatave Sportive të Kosovës
- Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, z. Besim Hasani, shprehu kënaqësinë e tij në lidhje me këtë takim dhe falenderoi autoritetet e KOKSH për këtë bashkëpunim, i cili, theksoi ai, “nënshkruhet në një kohë shumë të favorshme për Kosovën, duke qenë se pavarësia e saj sapo është shpallur zyrtarisht dhe që do të kontribuojë edhe në zhvillimin e sportit Kosovar”. Ndërsa Presidenti i KOKSH, z. Hysen Domi, pasi falenderoi të gjithë pjesëmarrësit e veçanërisht miqtë përfaqësues të Komitetit Olimpik të Kosovës e Federatave Sportive Kosovare, shprehu dëshirën e madhe për bashkëpunime të mëtejshme, të cilat janë në dobi të Promovimit të Sportit Shqiptar në arenën ndërkombëtare.
- Të dy Komitetet Olimpike u shprehën të bindur se ky bashkëpunim do të jetë në dobi edhe të Federatave homologe, nga të cilat ato Kosovare do të kenë mundësinë të njihen sa më shpejt në nivel ndërkombëtar, dhe t’u krijohet gjithashtu mundësia e bashkëpunimit edhe me Federata të vendeve të tjera.



Gjatë marrëveshjes së bashkëpunimit KOKSH - KOK.

ASAMBLEJA E SHOQATËS SË KOMITETEVE OLIMPIKE NDËRKOMBËTARE



Nga data 5 - 11 Prill 2008, Shoqata e Komiteteve Olimpikë Kombëtare (ANOC) zhvilloi Asamblenë e Përgjithshme në Pekin të Kinës, në të cilën morën pjesë drejtuesit e 205 Komiteteve Olimpikë Kombëtare, me qëllim diskutimin e çështjeve të lidhura me Lojërat Olimpikë "Pekin 2008". Në këtë evniment morën pjesë Presidenti i KOKSH, z. Hysen Domi, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, z. Stavri Bello dhe anëtari i Komitetit Ekzekutiv të KOKSH, z. Vladimir Gjonaj. Gjatë qëndrimit në Pekin, Delegacioni Shqiptar u takua edhe me Ambasadorin Shqiptar në Kinë, z. Maxhun Peka. Gjatë takimit u diskutuan problematika të ndryshme lidhur me përfaqësimin sa më dinjitoz të Delegacionit Shqiptar në Lojërat Olimpikë, si dhe mundësinë e organizimit në Ambjentet e Ambasadës të një pritjeje zyrtare për Delegacionin Olimpik Shqiptar dhe shqiptarët me banim në Pekin.

Z. Vladimir Gjonaj, z. Hysen Domi, z. Maxhun Peka, z. Stavri Bello.

SEMINAR - WORKSHOP ME SEKRETARËT E FEDERATAVE

Në datë 2 Prill 2008, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar zhvilloi një Workshop me Sekretarët e Federatave që do të marrin pjesë në Lojërat Mesdhetare "Pescara 2009", me qëllim përgatitjen për pjesëmarrje në këto Lojëra dhe hartimin e strategjive për secilën federatë. Të pranishëm në këtë Workshop ishin: Presidenti i KOKSH, z. Hysen Domi, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, z. Stavri Bello, Kryetari i Komisionit Teknik të KOKSH, z. Fidel Ylli si dhe përfaqësues të Federatave Shqiptare Sportive. Përfaqësuese nga MTKRS ishte zj. Violeta Shqevi, Drejtoreshë pranë Drejtorisë së Sporteve.

Presidenti i KOKSH, z. Hysen Domi, theksoi rëndësinë e zhvillimit dhe organizimit të një seminary të tillë, në ndihmë të punës së përbashkët që kryhet në të mirë të promovimit të sportit shqiptar. Më pas fjalën e mori zj. Violeta Shqevi, Drejtoreshë e Sporteve pranë MTKRS, e cila tha: "E vlerësoj maksimalisht këtë Workshop dhe shpreh bindjen se do të jetë në dobi të organizimit dhe përgatitjes sa më të mirë që KOKSH, Federatat e MTKRS do të kryejnë, në kuadrin e zhvillimit të Lojërave Mesdhetare "Pescara 2009".

Në vijim, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, z. Stavri Bello, ftoi të gjitha federatat të mobilizohen për një përgatitje sa më dinjitoze në Pescara 2009 dhe ecjen paralelisht me organizatorët e këtyre Lojërave, në mënyrë që nëpërmjet bashkëpunimit të KOKSH, MTKRS e Federatave, sportistët të motivohen dhe të kuptojnë se një nga shanset më të mira të Shqipërisë për pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare, janë Lojërat Mesdhetare.



Gjatë Workshop-it me sekretarët e Federatave.

MBLEDHJET E KOMISIONEVE TË KOKSH

MBLEDHJE E KOMITETIT EKZEKUTIV

Komiteti Ekzekutiv i KOKSH zhvilloi të Mërkurën, dt. 23 Prill 2008 mbledhjen e rradhës me rend dite:

- Masat për organizimin e Asamblesë së KOKSH:

Përgatitja e Raporteve të Komisioneve

- Informacion nga Komisioni Teknik mbi përgatitjen për “Pekin 2008”
Përfundimi i Projektit për talentet e reja dhe perspektiva për vitin 2008
- Informacion mbi Projektin Special të Komitetit Olimpik European.
- Informacion mbi takimin me Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Federatat.
- Kërkesë regjistrimi pranë KOKSH e Shoqatës “Ringjallja”.
- Kërkesë për anëtarësim pranë KOKSH e Shoqatës “Automobile Club Albania”.
- Shqyrtimi i kostove të analizave laboratorike anti – doping të qendrës Olimpike “Spyros Louis”, Athinë, si dhe mundësimin e ndonjë laboratorit të njohur nga CIO, për kryerjen e analizave të ekipit Olimpik.

MBLEDHJE E KOMISIONIT TEKNIK

Komisioni Teknik i KOKSH zhvilloi të Premten, dt. 21 Mars 2008, mbledhjen e dytë për vitin 2008, me rend dite si më poshtë vijon:

- ICMG – Bursa Mesdhetare për Sportistë (20 ditë kam stërvitor në një nga qendrat stërvitore të pellgut të Mesdheut për tre sportistë të sporteve individuale) - preferohen dy femra dhe dy meshkuj.
- Lojërat Mesdhetare “Pescara 2009”
- Përcaktimi i datës së Workshopit me Sekretarët e Federatave Sportive që do të marrin pjesë në Lojërat Mesdhetare.
- Draft Plani Strategjik i KOKSH mbi përgatitjen dhe pjesëmarrjen në “Pescara 2009”
- Formular i mbledhjes së informacionit nga Federatat për “Pescara 2009”.
- Analiza e projektit “2012 - Grante trajnimi për Sportistët e Rinj” për vitin 2007 dhe rishikimi i aplikimit për 2008.
- Ecuria e Bursave Olimpike “Pekin 2008”.
- Informacion nga Sekretarët e Federatave përfituese të bursave mbi ecurinë e përgatitjeve të sportistëve të kualifikuar apo edhe të atyre që përfitojnë bursë dhe priten të kualifikohen.



Mbledhje e Komisionit Teknik.

MBLEDHJE E KOMISIONIT FINANÇË – MARKETING

Komisioni Financë – Marketing pranë KOKSH zhvilloi më datë 31 Mars 2008 mbledhjen e rradhës, me rend dite:

- Vlerësim i ofertave dhe modeleve të dizajneve të paraqitura nga angjensi të ndryshme në lidhje me Posterin “PEKIN 2008” që do të përdorë KOKSH për fillimin e promovimit të ketyre Lojërave Olimpike .

Komisioni vlerësoi gjithashtu ofertat e kompanive të udhëtimit për delegacionin Olimpik Shqiptar në "Pekin 2008".

MBLEDHJE E KOMISIONIT “SPORTI PËR TË GJITHË”

Komisioni “Sporti për të Gjithë” pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar zhvilloi të Martën, dt. 29 Prill 2008, ora 13:00, mbledhjen e rradhës, me rend dite si më poshtë vijon:

- Shqyrtimi i projekteve për organizimin e “Dita Olimpike e Vrapimit 2008”.
- Propozime për Trofeun e IOC “Sporti dhe Rinia”.
- Aprovimi i Raportit të Komisionit për veprimtaritë e vitit 2007
- Diskutime të tjera për aktivitete të "Sporti për të Gjithë".



Mbledhje e Komisionit "Sporti për të gjithë".

MBLEDHJE E KOMISIONIT TË ETIKËS

Të Premten, dt. 07 Mars 2008, Komisioni i Etikës pranë KOKSH zhvilloi mbledhjen e parë të vitit 2008 me rend dite: Njohja me dokumentacionet e mëposhtme:

- Kodi i Etikës (pjesë integrale e Kartës Olimpike, miratuar me vendim të Bordit Ekzekutiv të CIOs në datë 26 Prill 2007, Pekin).
- Plani i implementimit të Kodit të Etikës
- Rregullat në lidhje me konfliktin e interesave që ndikojnë në sjelljen e palëve Olimpike.



Mbledhje e Komisionit të Etikës.

MBLEDHJE E KOMISIONIT MJEKËSOR

Komisioni Mjekësor pranë KOKSH zhvilloi më 7 Mars 2008 mbledhjen e parë për vitin 2008 me rend ditë si më poshtë vijon:

- Implementimi i Kodit Mjekësor të Lëvizjes Olimpike (Letër e Drejtorit të Komisionit Mjekësor dhe Shkencor pranë CIOs, Dr. Patrick Schamasch
 - Kodi Mjekësor i Lëvizjes Olimpike
- Në mbledhje u diskutua organizimi i një seminari mbi Kujdesin Mjekësor për sportistët me të gjithë Sekretarët e Federatave propozim i bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, z. Stavri Bello, dhe i miratuar nga të gjithë të pranishmit e tjerë.



Mbledhje e Komisionit Mjekësor.

MBLEDHJE E KOMISIONIT KAS

Këshilli i Arbitrimin Sportiv u mbledh më datë 18 Mars 2008 me qëllim shqyrtimin e çështjes së z. Andrea Xhori, i cili kishte paraqitur ankesën e tij pranë KAS kundrejt Federatës së Volejbollit.

KAS, pas administrimit të provave shkresore: Statutin e FSHV-së, Rregulloren e brendshme si dhe akte të tjera të paraqitura nga kërkuesi, vendosi rrëzimin e kërkesës së z. Andrea Xhori si të pabazuar.



Mbledhje e KAS.

KOMISIONI "FEMRA DHE SPORTI"

Komisioni "Femra dhe Sporti" pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar zhvilloi të Hënën, dt. 31 Mars 2008 mbledhjen e parë të këtij Komisioni për vitin 2008, me rend dite si më poshtë vijon:

- Raport mbi aktivitetin e Komisionit "Femra & Sporti" gjatë vitit 2007
- Informacion mbi zhvillimin e Konferencës së IV Ndërkombëtare "Femra dhe Sporti", me temë "Sporti si mjet i ndryshimit social", Jordani
- Promovimi i buletinit "Femra dhe Sporti"
- Të ndryshme.



Mbledhje e Komisionit "Femra dhe Sporti".

MBLEDHJE KOMISIONI TEKNIK COE

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, z. Stavri Bello, mori pjesë në mbledhjen e Komisionit Teknik të Komitetit Olimpik European, e cila u zhvillua në Romë, në datat 29/02/2008 – 02/03/2008. Gjatë mbledhjes u morën një sërë vendimesh; ndër më të rëndësishmit ishte edhe organizimi i një seminari në nivel European lidhur me konkluzionet e Lojërave Olimpikë "Pekin 2008".



Gjatë mbledhjes së Komisionit Teknik COE.

MBLEDHJE KOMISIONI TEKNIK ICMG

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, z. Stavri Bello mori pjesë në mbledhjen e Komisionit Teknik të ICMG – së, e cila u zhvillua në datat 04 – 06 Mars 2008. Ky komision po vëzhgon nga afër përgatitjet e Komitetit Organizator të Lojërave Mesdhetare "Pescara 2009".



Gjatë mbledhjes së Komisionit Teknik ICMG.

TAKIM ME FEDERATËN E NOTIT

Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, z. Hysen Domi dhe z. Stavri Bello, pritën pranë zyrave të KOKSH Presidentin dhe Sekretaren e Përgjithshme të Federatës Shqiptare të Notit, z. Feim Alliu dhe zj. Suela Haxhija, në kuadrin e Lojërave Olimpikë "Pekin 2008". Gjatë takimit u diskutua pjesëmarrja dhe përgatitja e notarëve në Lojërat Olimpikë "Pekin 2008".

Gjatë takimit me Presidentin dhe Sekretaren e Përgjithshme të FSHN.



AKTIVITET I FEDERATËS SHQIPTARE TË PESHËNGRITJES



Seminar Kualifikimi i Federatës Shqiptare të Peshëngritjes.

Me mbështetjen e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federata Shqiptare e Peshëngritjes ka organizuar me sukses në datat 15-16 Mars 2008 "Kursin dy ditor të Kualifikimit të Trajnerëve të Peshëngritjes". KOKSH e ofron këtë kurs me qëllim azhurnimin dhe ngritjen në një shkallë më të lartë kualifikimi të trajnerëve që merren me trajnimin e sportistëve në përgjithësi, të talenteve të reja dhe të sportistëve të elitës në vecanti. Nga ana tjetër KOKSH mbështet organizimin e kurseve të tilla për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të kualifikimit të vazhdueshëm të trajnerëve pranë Federatave Sportive.

I ndarë në seanca teorike dhe praktike, në kurs morën pjesë 20 trajnerë të licënuar të FSHP nga qytete të ndryshme të Shqipërisë. Kursi u drejtua nga Prof. Asoc. Dr. Përparim Ferunaj,

TAKIM ME ZV/AMBASADOREN E KINËS NË SHQIPËRI, ZJ. JIANG CHUNYAN

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, z. Stavri Bello, priti të Enjten, dt. 17 Prill 2008 pranë zyrave të KOKSH, zv/Ambasadoren e Kinës në Shqipëri, zj. Jiang Chunyan. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi organizimin e një Ekspozite fotografike që do të organizojë Ambasada Kineze në Shqipëri, më 24 Qershor 2008. Gjatë takimit u diskutua edhe promovimi i Lojërave Olimpike "Pekin 2008" dhe vlerave të tyre në edukimin e rinisë.



Gjatë takimit me zv/Ambasadoren e Kinës në Shqipëri.

AKTIVITET I FEDERATËS SHQIPTARE TË ALPINIZMIT



Federata Shqiptare e Alpinizmit zhvilloi me sukses në muajin Prill 2008 Kampionatin e Dytë Kombëtar "Ngjitja në murin Alpin" me një pjesëmarrje të gjerë, e cila ndihmoi në promovimin e mëtejshëm të këtij sporti në vendin tonë.

Gjatë Kampionatit të II Kombëtar "Ngjitja në Murin Alpin".

SHOQATA E LOJËS BRIDGE

Në Kampionatin European të lojës Bridge zhvilluar në qershor 2007, në Antalya të Turqisë, nga Shqipëria mori pjesë çifti Kapo-Xhuli, të cilët u vlerësuan me një çmim prestigjioz.



Foto masive gjatë aktiviteteve të Shoqatës së lojës Bridge.



**Raiffeisen
BANK**

Co-Sponsorë Gjeneral të KOKSH
në Lojërat e 29-ta Olimpikë Verore "Pekin 2008"

THANK YOU



THE WORLDWIDE OLYMPIC PARTNERS

Coca-Cola

Atos Origin



Johnson & Johnson

Kodak

lenovo

Manulife



OMEGA

Panasonic

SAMSUNG

VISA



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Raiffeisen BANK



Co-Sponsorë Gjeneral të KOKSH
në Lojërat e 29th Olimpikë Verore "Pekin 2008"